

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / Kabineti i Kryetarit të Komunës

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 959 Nr ifaq/Br.str/No.pg 97
RAHOVEC / ORAHOVAC
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Njësia e personelit / Kadrovska Jedinica / Personnel Unit

Me datë 15.06.2020
Rahovec

Për/Za/To: Z. Smajl Latifin, Kryetar i komunës së Rahovecit

Nga/Od/From: Ymret Reshiti, Udhëheqësi i personelit të komunës së Rahovecit

Lënda /Svrha/Subjekt/: Raporti gjashtë mujor i punës për periudhën Janar-Qershor 2020

I nderuar Kryetar,

Po ju prezantoj raportin gjashtë mujor i punës për periudhën Janar-Qershor 2020, të Njesisë së Personelit të administratës së komunës së Rahovecit. Koha e pandemisë së pasojë e virusit covid-19, ka pamundësuar kryerjen e shumë aktiviteteve ngase si institucione nuk kemi punuar nga 12 marsi deri me dt.01.06.2020.

1. REKRUTIMET

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur dy (2) konkurse publike. Në shërbimin civil nuk ka pasur asnjë konkurs-rekrutim të personelit. Vetëm 2 konkurse publike janë shpallur për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, si në vijim:

Konkurset publike me Marrëveshje për Shërbimet e Veçanta.

Konkursi nr.259/2020 për DGJKP për dy pozita :

1.Arbnor Kabashi nga Opterusha. Zyrtar për kadastër nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

2.Fidan Durguti nga Rahoveci, Zyrtar për kadastër nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DBPZH-Zyrtar për pagesa direkte-subvencione:

1.Donjeta Dina nga Krusha e Madhe nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
2.Bahrije Çmega nga Rahoveci nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.

3. Valmir gashi nga Nagavci nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
- 4.Bekim Krasniqi nga Ratkoci nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
- 5.Burim Bellanica nga Krusha e Madhe nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
- 6.Egzon Thaçi nga Xërxa nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
- 7.Zyber Thaçi nga Çifllaku nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DSHPK për 2 pozita:

- 1.Minire Berisha ,Inxhinieri e hidros nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.
- 2.Shpejtim Bajraktari nga Gjakova, Zyrtar i teknologjisë informative nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për Drejtoria për Arsim për 2 pozita:

- 1.Dafina Gashi nga Bellacërka, Zyrtare për arsimin fillor dhe të mesëm nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.
- 2.Fadil Gashi nga Dejni ,Zyrtar për arsimin fillor nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DUPMM për 1pozitë:

- 1.Jetmir Ukaj nga Radosta , Arkitekt nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DPI për 1pozitë:

- 1.Teute Vuçitërna nga Rahoveci, Zyrtare administrative nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DBF-Zyrtar për tatim në pronë,4 pozita:

- 1.Elmedina Spahiu nga Rahoveci nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.
- 2.Pajtim Haxhijaha nga Rahoveci nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.
- 3.Qëndresa Kryeziu nga Xërxa nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.
- 4.Minire Hoti nga Ratkoci nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DEZHT për 1pozitë:

- 1.Faik Thaçi nga Çifllaku, Zyrtar në Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve nga data 02.03.2020 deri më 01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për DKRS për 6 pozita:

- 1.Granita Behra nga Krusha e Madhe-Bibliotekiste nga dt.24.02.2020 deri me dt.23.08.2020.
- 2.Edin Shtavica nga Rahoveci,Zyrtar për sport nga dt.02.03.2020 deri me dt.01.09.2020.
- 3.Shpëtim Dulaku nga Opterusha,Zyrtar për sport nga dt.02.03.2020 deri me dt.01.09.2020.
- 4.Albulena Rexha nga Rahoveci,Zyrtare për rini nga dt.02.03.2020 deri me dt.01.09.2020.
5. Behar Hoti nga Ratkoci,Zyrtar për ruajtjen e monumenteve kulturore dhe historike, nga dt.02.03.2020 deri me dt.02.09.2020.

Konkursi nr.260/2020 për DKRS për 1 pozitë:

- 1.Myrtazan Dula nga Rahoveci,Zyrtar për Administrimin e Palestrës nga dt.02.03.2020 deri me dt.01.09.2020.

Konkursi nr.259/2020 për Drejtoria për Administratë për pozitën- Zyrtar për ofiqari :

- 1.Vjollca Berisha nga Ratkoci nga dt.02.03.2020 deri me dt.01.09.2020.

Konkursi nr.260/2020 për Drejtoria për Administratë për pozitën-Koordinator për të pagjeturit e komunës së Rahovecit:

- 1.Selami Hoti nga Krusha Madhe nga dt.02.03.2020 deri me dt.02.09.2020.

Njësia e Personelit me kohë i ka përgatitur dokumentacionin dhe formularët për të gjitha konkurset e shpallura, ka përgatitur dhe dërguar ftesat për kandidatët, vendimet për komisionet e rekrutimit, MVSH-të, udhëzime dhe punët e tjera.

2. PUSHIMET VJETORE

-Pandemia Covid-19 ka pamundësuar shfrytëzimin e ditët e mbetura të pushimit vjetor 2019 sepse një kohë stafi nuk ka punuar .

Rekomandohet të respektohet Rregullorja e MAP-së, Nr.06/2011 Për Pushimet e Nëpunësve Civil .

3. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 65 shkresa administrative si në vijim: vërtetime, vendime, draft vendime, propozim , akt emërimi, informata , MVSH , përgjigje në ankesa, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa tjera si dhe ka dërguar mbi 49 emaile zyrtare .

4.TABELAT STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të personelit Njësia e personelit tani i procedon drejtpërdrejt në programin elektronik SIMBNJ sipas kërkesës së MAP/DASHC-së. që bëhet rregullisht.

Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

-Administrata komunale ka gjithsej 161 pozita, pa sektorin e arsimit dhe shëndetësisë Prej këtyre të plotësuara janë 150, ndërsa 11 pozita janë të lira.

5. VLËRËSIMI I PUNËS PROVUESE

Gjatë kësaj periudhe kohore është vlerësuar puna provuese e 3 punëtorëve. Të gjithëve iu është konfirmuar kryerja me suksese e punës provuese.

- 1.Antigona Rexha Ramaj, Zyrtare në QPS
- 2.Jeton Krasniqi, Zyrtar në Drejtorin e Arsimit
- 3.Liridon Gashi ,Zyrtar në DBF.

6.VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Funksionon Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP .

Janë lëshuar kartela të reja të SMVP-së për të gjithë punëtorët por vërehet se disa punëtor nuk po i përmbahen udhëzimeve të dhëna në tabelat e informimit se si të përdoret SMVP-ja ,gjë që nuk po krijon pasqyrë reale.

Ju rekomandohet që të obligoni drejtorët e drejtorive që për këtë çështje të kërkojnë nga punëtorët e tyre që të respektohen udhëzimet e përdorimit të SMVP-së në të ardhmen. Me email zyrtar kam njoftuar gjithsecilin punëtor dhe epror që kartelat e vijueshmërisë duhet të përdoren sipas udhëzimeve por një pjesë e tyre vazhdojnë që të mos i përmbahen këtyre udhëzimeve.

Mos aplikimi i sistemit të vijueshmërisë dhe mos përmbajtja e udhëzimeve të përdorimit të kartelave parqet rrezikun se mund të dështoj qëllimin që ka ky sistem dhe se mund të krijojë të dhëna jo të plota për vijueshmërinë e punës së punëtorëve.

7. TRANSFERIMIET E PUNËTORËVE /AVANCIMET /NDRYSHIMET NË POZITË

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë transferim të brendshëm dhe asnjë avancim të punëtorëve.

8. NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Gjatë kësaj periudhe tre (3) punëtorëve i ka pushuar marrëdhënia e punës. Punëtorëve që iu ka pushuar marrëdhënia e punës janë:

1. Halit Krendali nga Rahoveci nga dt.29.01.2020 pensionim
2. Ibrahim Thaç nga Qifllaku nga dt.03.02.2020 pensionim
3. Nazife Hundozi nga Rahoveci nga dt.07.06.2020 pensionim.

9. TRAJNIMET E NËPUNËSVE CIVIL

Udhëheqësi i personelit iu ka njoftuar për çështjen e trajnimeve dhe ju për të vënë rregull dhe monitorim të procesit të trajnimeve ngase punëtorët kanë shkuar në trajnime sipas dëshirës së tyre .

Ju si Kryetar i komunës keni nxjerr një Urdhëresë me të cilin keni obliguar drejtorët e Drejtorive komunale, që çdo ftesë për trajnim t'iu dërgohet juve dhe Udhëheqësit të personelit për vlerësim paraprak, nëse u lejohet që të ndjekin atë trajnim.

Me autorizimin tuaj vitin 2018 edhe unë iu kam dërguar drejtorëve një email zyrtarë për këtë çështje.

Kam informata që kjo Urdhëresë nuk po gjenë zbatim në praktik, prandaj ju rekomandohet juve që të merreni me ecurinë e procesit të zbatimit.

Nëpunësit civil nuk po informojnë Njësinë e Personelit kur nuk dëshirojnë të shkojnë në trajnimin që është caktuar dhe nuk po i sjellin certifikatat e trajnimeve të ndjekur.

Deri tash ka ndjekur trajnim 1 nëpunës civil .

Është hartuar plani i trajnimit të nëpunësve civil të komunës për vitin 2020 dhe është dërguar në DASHC/ MAP.

10. VENDIMET NGA KPMSHCK-së

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës nuk kemi asnjë vendim.

11.TË DHËNAT NGA KOMISIONET E SHËRBIMIT CIVIL TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

I. Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur vetëm asnjë rast për ndjekje disiplinore.

Njësia e Personelit të gjithë punëtorëve dhe ekzekutivit ia ka shpërndarë nga një kopje të Kodit Etik të komunës së Rahovecit.

II. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 2 ankesa.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka aprovuar pjesërisht ankesën e Nesimi Sharkut nga Rahoveci.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka një ankesë në shqyrtim.

Njësia e personelit i kryen punët e sekretarisë për Komisionin Disiplinor dhe Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke i lëshuar shkresat administrative përveç vendimeve, të cilat nuk ka të drejtë.

12.MENAXHIMI I BURIMEVE NJËRËZORE SIPAS PROGRAMIT “ SIMBNJ”.

Në vazhdimësi Njësia e personelit menaxhon me programin elektronik SIMBNJ duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program sipas kërkesave që parashtron MAP-ja.

Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe ka hyrë si prioritet i reformës së administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës.

13. PLANI INDIVIDUAL I PERSONELIT

Njësia e personelit ka hartuar draft Planin Individual të Personelit të komunës së Rahovecit për vitin 2020 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

Asnjë punësim në shërbimin civil nuk mund të realizohet nëse pozitat nuk janë të përfshira në Planin Individual të Personeli .

14. ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth, Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore .
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve –pra programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL , pra programit të listave pagave dhe pagesave të komunës.